



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE



ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Data/Datum/Date:	17. 1. 2024
Nr./Br./No	02/14
Për/Za/To:	z. Qemajl Aliu, kryetari i komunës së Shtimes
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	Vlora Hyseni, zyrtare për Informim
Lënda/Predmet/Subject:	Raporti i punës së kryetarit të Komunës së Shtimes, Qemajl Aliu për vitin 2023

Raporti është përgatitur duke u bazuar në UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNË

Më datë 15 dhjetor 2023 është publikuar njoftimi për organizimin e takimit të dytë publik me qytetarë i kryetarit Qemajl Aliu për punën gjashtëmujore të dytë për vitin 2023.

Organizimi i takimit është bërë nga kryetari-Kabineti i Kryetarit dhe Zyra për Informim.

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në Facebook:

Më datë 15.12.2023 është publikuar njoftimi për organizimin e këtij Takimi Publik që do të mbahej. Njoftimi është publikuar në web-faqen e Komunës dhe Facebook-un e Komunës.

-Publikimi në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/shtime/ep-content/uploads/sites/28/2023/12/FTESE-PER-TAKIM-PUBLIK-ME-QYTETARE-me-28-dhjetor-2023.pdf>

-Publikimi në facebook:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=683658333890355&set=a.261309532791906>

Me 28 dhjetor 2023, duke filluar nga ora 15:00 është mbajtur Takimi Publik ku është paraqitur para të pranishmëve Raporti për Gjashtëmujorin e Dytë të Punës së Ekzekutivit dhe në tërësi për punët e bëra gjatë vitit 2023.

Të pranishëm në këtë Takim Publik kanë qenë kryetari Qemajl Aliu, Kabineti i Kryetarit përfshirë Drejtorët e Drejtorive, Zyrtarë Komunalë, OJQ, media dhe qytetarë.

Hapja e këtij takimi është bërë nga asistentja e Kryetarit të Komunës, Gentiana Mehmeti, e cila ka falënderuar të pranishmit duke thënë se tani do të paraqitet puna e gjashtëmujorit të dytë të Ekzekutivit për vitin 2023 si dhe në tërësi puna e bërë gjatë vitit 2023.

Kryetari, Qemajl Aliu në fillim të takimit ka falënderuar qytetarët, kabinetin qeverisës, shoqërinë civile, kuvendarët dhe të gjithë të tjerët duke thënë se së bashku janë munduar t'i realizojnë objektivat e paraqitura për vitin 2023, ku ka prezantuar edhe punët e kryera gjatë 1 viti.

Si qeverisje e mirë, jemi kualifikuar komunë fituese e grantit të performancës që u jepet vetëm komunave që i plotësojnë kriteret strikte. Do të përfitojmë për vitin e ardhshëm rreth 1 milion euro shtesë vetëm për projekte kapitale.

Buxheti dhe rritja e të hyrave vetanake – Buxheti – 9.9 milionë; rritja rekorde e të hyrave:

Rritja e subvencioneve në Sport dhe Kulturë nga viti: 2021 – 33,500 euro; 2022 – 40,000 euro; 2023 – 106,000 euro

Investime kapitale – Rritje nga 1.9 milionë në 2.35 milionë ose mbi 400 mijë euro.

Subvencione – Dyfishim ose rritje 100 për qind nga 150 mijë në 300 mijë euro – nga viti 2022 në vitin 2023

Investimet tona janë hartuar në përputhje me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të cilat i kemi pranuar përmes dëgjimeve buxhetore për secilin fshat dhe zonat e qytetit të Komunës sonë

Investimet kapitale të përfunduara:

Ndërtimi Parkut në Davidovc – 144 mijë euro

Projektit investiv 90.000 euro në Rashincë, me shtigje të ecjes, çiklizmit dhe ndriçimit publik

Transformim i rrugës së Vojnocit, me zonë të dedikuar për këmbësorë e tëra e pajisur me ndriçim publik – 95 mijë euro

Asfaltimi i rrugës së Tranzitit – 1.2 milionë euro

Projekti i renovimit të plotë në vlerë prej 200.000€ të shkollës “Emin Duraku” – Shtime dhe renovimi i gjimnazit “Naim Frashëri” - nga Fondi për Eficiencë të Energjisë

Fuksionalizimi i çerdhes moderne në Muzeqinë – 70 mijë euro

Renovimi i objekteve shëndetësore dhe arsimore – renovime të domosdoshme në vlerë 200 mijë euro

Përrurimi i kabineteve shkollore në vlerë 115,000 euro në shkollat e Mesme Profesionale, Gjinnazi "Naim Frashëri" dhe shkolla në Gjyrkoc

Përfundimi i punimeve në ndërtimin e parkut në lagjen Hysenaj, në fshatin Petrovë, 32 mijë euro.

Ringjallja e Shtëpisë së Kulturës përmes aktiviteteve me shfaqje dhe filma

Instalimi i sistemit të alarmit në 6 shkolla dhe kamerave në 7 shkolla – vlera 23.000 euro

Rregullimi i vendndaljeve për autobus në 6 fshatra, vitin tjetër i pajisim edhe 7 fshatra. Vlera 70 mijë euro.

Rregullimi i ndriçimit publik në 10 fshatra dhe i kanalizimit në 9 lokalitete

Rehabilitimi/ndërtimi i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe riparime në ujësjellës dhe kanalizim do të mundësojnë investime në infrastrukturën e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Kjo vlerë arrijnë mbi 250 mijë euro. - Godanc-Gjyrkoc-Muzeqinë

Punimet në vlerë 84 mijë euro në kanalin atmosferik në gjatësi 600 metra dhe me vendosje të gypit me gjerësi fi800. – Shtime

Funksionalizimi i "Dhomës mike" në Stacionin Policor Shtime – për trajtimin e viktimave të dhunës në familje

Në çerdhen "Albiona Asllani" është realizuar projekti për ndërtimin e këndit të jashtëm të lojërave

Këtë vit filluan këto investime:

Rregullimi i urës si dhe rivitalizimi i tërësishëm i rrugëve që i lidhin Pjetërshticën, Carralevën, Zborcin dhe Godancin e Epërm, në vlerë plot 637.000€

Rregullimi i rrugës te Kulla e Lirisë mbi Memorialin e Masakrës së Reçakut, e cila do të kompletohet me infrastrukturë të plotë: asfaltim, trotuar dhe ndriçim. Vlera 370 mijë euro.

Ndërtimi i çerdhes së re në Godanc - investim në vlerë 414.643.49 mijë eurosh - pesë klasa për fëmijë të grup-moshave 9 muaj deri 5 vjeç – 72 shtretër

Ndërtimi i fazës së katërt për projektin e rregullimit të sheshit, në vlerë 268.000€

Kanale të kullimit të tokave bujqësore në vlerë 336 mijë euro - përshkon sipërfaqe totale 215 ha

Finalizimi i fazës së parë të punimeve te Tregut të Hapur të Qytetit – faza e parë në vlerë 340 mijë euro tashmë e përfunduar

Nisja e ndërtimit të 10 shtëpive të reja familjeve në nevojë në bashkëpunim me Shoqatën "Jetimat e Ballkanit", në vlerë **50,000 euro**

Ndërtimi i Shtabit të Rancës në vlerë 125 mijë euro – përrurimi i rrugës për tek Shtabi – ruajtja e vlerave të Luftës së UÇK-së

Rifillimi i punimeve në rrugën 2.8 kilometërshe "17 Shkurti" që përshkon fshatrat Godanc, Gjyrkoc dhe Muzeqinë

Projekti "TAKE" në vlerë 21.000 euro - Pesë institucione arsimore të komunës përfituan inventarë dhe pajisje didaktike për klasat parafillorë.

Bibloteka dhe Arkiva e qytetit në përfundim të punimeve – objekt modern në vlerë – Afro 300 mijë euro

Ndërtimi i 5 parqeve – Muzeqinë, Rashincë, Godanc i Epërm dhe i Poshtëm, Shtime – hapësirë rekreative për të gjitha moshat

Rregullimi i shtigjeve të Motto-Cross dhe parkut te Pishat

Subvencione

Për herë të parë subvencionohen studentët që studiojnë jashtë vendit

Numri më i madh studentëve që kanë përfituar bursa arsimore për një vit – 80 përfitues

27 përfitues të serrave

33 përfitues të mëshqerrave barrëse

216 bujq përfitues të farës së misrit

29 përfitues të mjeteve bujqësore - realizim të premtimit për modernizim të bujqësisë

3000€ për subvencionimin e OJQ-ve lokale që i kontribuojnë komunitetit;

Kemi aprovuar 236 kërkesa të cilat janë subvencionuar në vlerë prej 24,000 euro për nënat lehona

Shtëpia e Komunitetit dhe QKMF janë furnizuar me barna esenciale për pacientët e tyre në vlerë 102 mijë e 735 euro – vlera më e madhe ndonjëherë.

E kemi miratuar Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik 2023/2027

Ndriçim në Vojnoc Rashincë, Zborc e më shumë siguri për banorët

Në Gjyrkoc gjatësia e trotuarit që po shtrohet është 480 metra, në Mollopolc 650 metra, dhe në Davidoc 600 metra.

Pas ndriçimit publik dhe disa investimeve në fshatin Vojnoc, tashmë kanë përfunduar edhe punimet për rregullimin e një pjese të trotuarit në gjatësi prej 600 metrash.

2 km më shumë trotuare Mollopolc, Davidoc, Gjyrkoc, Vojnoc

po i shtohen Komunës sonë, trotuarin në fshatrat si dhe në qytet.

Asfaltimi i segmeteve të rrugëve në: Shtime, Zborc, Rancë, Gllavicë, Pjetërshticë, Reçak, Godanc të Epërm, Rashincë, Godanc i Poshtëm, Carralevë, Lagje e Pajtimit, Petrovë, Muzeqinë, Belinc, Davidoc, Gjyrkoc, Mollopolc, Dugë.

Pas prezantimit të punës të bërë, Kryetari i Komunës Qemajl Aliu, hapi debatin për pyetje dhe diskutim nga të pranishmit.

Takimi Publik u përmyll me premtimin se vitet në vazhdim e presin Shtimen me investime shumë më të mëdha.

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komente	Njoftimi
Diskutim Publik për gjashtëmuajt e dytë të 2023-ës për punën e Ekzekutivit	Zyra e kryetarit	Rreth 50 pjesëmarrës	Salla e Kuvendit të Komunës Shtime 28 dhjetor 2023		https://kk.rks-gov.net/shtime/ep-content/uploads/sites/28/2023/12/FTES-E-PER-TAKIM-PUBLIK-ME-QYTETARE-me-28-dhjetor-2023.pdf